

LAGUNA

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



GHS09

“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

Laguna është një insekticid me spektër të gjerë për përdorim në kulturat të ndryshme bujqësore, kundër insekteve të ndryshme me aparat gojor ti tipit brerës. Ky insekticid është krijuar posaçërisht për përdorim në skemat e menaxhimit të integruar të dëmtuesve (IPM). Laguna është një insekticid i grupit diamid antranilik në formën e një suspensiononi të koncentruar.

Lënda vepruese: 200g/lit chlorantraniliprole

Formulimi: *Suspension i koncentruar (SC)*

Masat parambrojtëse

Deklaratat e rrezikut

H410: Shumë toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata.

EUH401: Të evitohen rreziqet e shendetit të njeriut dhe ambientit, në përpuethshmëri me instruksionet për përdorim.

Deklaratat (Të përgjithshme)

P101: Në rast helmimi tregojeni mjekut etiketën e produktit.

P102: Mbajeni në vende të sigurta, larg fëmijëve.

P103: Lexoni etiketën para përdorimit.

Deklarata parandaluese :

P270: Mos hani, pini ose pini duhan kur përdorni këtë produkt.

P273: Shmangni rrjedhjet në mjedis.

P280: Vishni doreza mbrojtëse/ veshje mbrojtëse/ pajisje mbrojtëse për fytyrën/ pajisje mbrojtëse për sytë.

P391: Mblidhni dhe pastroni rrjedhjet

P405: Mbajeni të kyçur.

P501: Shkatërrimi i permbajtjes /shisheve ne perputhje me rregullat në fuqi.

GROUPI

28

INSECTICID

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

Mbani me vete ambalazhin e produktit, etiketën ose fletën e të dhënave të sigurisë kur telefononi një qendër kontrolli helmimi ose një mjek. Nëse nuk ndiheni mirë, kërkoni kujdes mjekësor.

Pas thithjes me frymëmarrje: Furnizoni ajër të pastër; konsultohuni me mjekun në rast ankesash.

Pas kontaktit me lëkurën: Hiqni rrobat dhe këpucët e kontaminuara. Lani zonën e prekur me shumë ujë. Kërkoni kujdes mjekësor nëse është e nevojshme. Lani rrobat e kontaminuara përpara përdorimit.

Pas kontaktit me sy: Mbajini sytë hapur dhe shpëlajini ngadalë dhe lehtësisht me ujë për 15-20 minuta. Hiqni lentet e kontaktit, nëse janë të pranishme, pas 5 minutave të para, pastaj vazhdoni të shpëlani sytë. Telefononi një qendër kontrolli helmimi ose një mjek për këshilla për trajtimin.

Pas gëlltitjes: Shpëlajeni gojën dhe më pas jepini 1-2 gota me ujë. Merrni këshilla mjekësore.

Përdorimi:

Mos aplikoni më shumë se dy herë në sezon. Ky insekticid aplikohet në 300-800litra ujë për Ha.

Në Panxhar, Karrotë, Selino, Argjinare, Majdanoz, Rrepkë, rrepë, rrilkë, për kontrollin e Mizës së rrënjëve të karrotës (*Psila rosa*) me dozë 175 ml/Ha. Aplikohet gjatë vendosies së vezëve (para pikut të fluturimit të mizave të rritura), mundësisht kundër breznisë së dytë ose të tretë. Max.2 aplikime në vit me një minimum prej 14 ditësh ndërmjet aplikimeve.

Domate, patëllxhan, kungull për kontrollin e specieve të Lepidoptera duke përfshirë: Tenjën e domates (*Tuta absoluta*), Spodoptera sp., *Heliothis* sp. 140-200 ml/Ha (0.140-0.200lit/Ha). Aplikojeni gjatë çeljes së vezëve, kur vihet re dëmtimi i parë. Mos bëni më shumë se 2 aplikime në vit me një minimum prej 7-14 ditë midis aplikimeve.

Brokoli, Lakër, Lulelakër, Lakra e Savojës, për kontrollin e specieve të Lepidopterëve, Krimbat e lakrës *Plutella xylostella*, *Mamestra brassicae*, *Pieris rapae*, *Pieris brassicae*, *Evergestis forficalis*, *Clepis spectrana* me dozë 125 ml/Ha. Aplikojeni gjatë vendosjes së ve zëve derisa vezët e para të çelin. Max. 2 aplikime në vit.

Misër për kontrollin e Krimbi misrit (*Ostrinia nubilalis*) me dozë 125 ml/Ha. Aplikojeni gjatë vendosjes së vezëve derisa vezët e para të çelin, duke përdorur rekomandimet e kohës për materialet ovi-larvicide, aty ku janë në dispozicion. Max.2 aplikime në vit.

Patate për kontrollin e Buburrecit të patates (*Leptinotarsa decemlineata*) me dozë 20-60 ml/Ha. Trajtojeni në momentin e daljes së vezëve ose sapo të shfaqen shenjat e para të dëmtimit. Aplikohet me interval 14 ditë, maksimumi dy aplikime.

Mollë, Dardhë, Kumbull për kontrollin e krimbit (*Cydia pomonella*) 150-175ml/Ha, duhet alternuar me insekticide të tjera. Trajtojeni në momentin e daljes së vezëve ose sapo të shfaqen shenjat e para të dëmtimit. Aplikohet me interval 14 ditë, maksimumi dy aplikime.

Pjeshkë, kajsi për kontrollin e *Cydia molesta*, aplikohet 160-200ml produkt për Ha (0.160-0.200lit/Ha). Trajtojeni në momentin e daljes së vezëve ose sapo të shfaqen shenjat e para të dëmtimit. Aplikohet me interval 14 ditë, maksimumi dy aplikime. LAGUNA duhet të aplikohet në alternim me insekticide të tjera për të shmangur fenomenin e rezistencës.

Rrush për kontrollin e tenjave, *Lobesia botrana*, *Eurpoecilia ambiguella*, Toriksit të rrushit *Argyrotaenia pulchellana* me dozë 150-210 ml/Ha në 600-1200litra ujë për Ha, 1 trajtim në sezon dhe duhat alternuar me insekticide me mënyrë tjetër veprimi.

Fitotoksiciteti:

Nuk është fitotoksik kur përdoret në kulturat e mësipërme dhe sipas dozave të rekomanduara në këtë etiketë.

Vërejtje për përdorimin:

Mos e përdorni në kulturat në kushte stresi (nga përmbytjet, thatësira, temperaturat e ulëta, etj.). Për të mbrojtur bletët dhe pjalmuesit e tjerë, mos aplikoni në periudhën e lulëzimit ose kur bimët e tjera janë në lulëzim. Përdoreni kur bletët nuk kërkojnë ushqim në mënyrë aktive, (në mëngjes herët ose në mbrëmje vonë). Nuk përzihet me produktet e tjera, nëse bëni përzierje duhet të bëni një provë paraprakisht. Gjatë përzierjes Laguna hidhet e para.

Ndikimi në ekosistem:

Toksik për invertebrorët ujorë. Pak helmues për gjitarët. Shumë pak helmues për zogjtë. Pak helmues për bletët, prandaj duhet të shmangim trajtimet në periudhën e lulëzimit dhe në orët e mesditës ku dhe aktiviteti i bletëve është më i madh. H410: Shumë toksik për gjallesat ujore duke shkaktuar efekte afatgjata të dëmshme. SP1: Mos ndotni ujin me produktin ose ambalazhin e produktit. Mos i pastroni paisjet e spërkatëse pranë sipërfaqeve me ujë të rrjedhshëm ose në kanale e rrugë. Shmangni hedhjen në mjedis. Ruani një distacë buffer (të pa trajtuar) 20m ndaj burimeve të ujit gjatë trajtimit.

Karenca: Hardhi rrusi 42 ditë, Panxhar, Karrotë, Selino, Rrepa pikante, Argjinare, Pastinak, Rrepë, Rrepkë, Majdanos 21 ditë. Mollë, Dardhë, Patate, Kumbull, Misër, Pjeshkë, Kajsi 14 ditë. Domate, Patëllxhan, Kungull 1 ditë, Brokoli, Lulelakër, Lakër, Lakra e Savojës, 7 ditë , Lakër 3 ditë.

Ruajtja dhe magazinimi: Ruhet në vende të errta, të fresketa larg të nxehtit, të mbrojtura nga rrezet direkte të diellit dhe në ambalazh origjinal. Mbajeni larg ushqimeve për njerzit dhe blektorinë. Mbajeni në vende të sigurta, larg fëmijëve. Tundeni para përdorimit, ruajeni nga ngrirja.

Nr dhe data e regjistrimit: Nr. 21 datë 17.07.2025

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1 Lit.

Bar kodi përkatës.....;

Data e prodhimit.....;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 3 vite;

Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenja të tjera identifikuese: *Printuar nga makineria në amabalazh.*;

Tipi i ambalazhit bazë: Shishe COEX ose HDPE

Emri dhe adresa e Aplikantit: Galenika-Fitofarmacija d.o.o. Adresa: Trzaska cesta 515 I SI-1351 Brezovica pri Ljubljane Slloveni.

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: Galenika-Fitofarmacija a.d. Adresa: Batajnicki drum bb Beograd Serbi.

Distributori për Shqipërinë: AGROHELP-SA. Adresa: Autostrada Tiranë –Durrës km 22 Durrës, Shqipëri.